



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KAVAJE

## RAPORT

### MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT DHE VEPRIMTARINE E PROKURORISE PER VITIN 2017

KAVAJE 2018



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**  
**K A V A J E**

Adresa : Lagja nr.5 Rr “Unaza Qytetit”

Kavaje me 31.01.2018

## **R A P O R T - A N A L I Z E**

**Mbi veprimtarine e punes dhe ushtrimin e detyrate te vitit 2017, nga  
Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje.**

Raporti vjetor “Mbi gjendjen e kriminalitetit per vitin 2017” paraqitet ne perm bushje te nenit 50 te ligjt nr.97/2016 “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise”.

Ne kete raport paraqitet ne menyre te plote e me realizem, gjendja e kriminalitetit , te dhena dhe shpjegime per numrin, llojin, shtrirjen, itensitetin dhe format e kriminalitetit ne juridikcionin e Prokurorise Kavaje, si dhe drejtimet dhe perparesite qe kerkojne zgjidhje, me synim rritjen me tej te efikasitetit ne lufthen kunder kriminalitetit.

Periudha vjetore 2017 qe analizojme, referuar veprimtarise se ushtrimit te detyrate te ngarkuara me ligj, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyquesore Kavaje e ka ushtruar veprimtarine e saj ne mbeshtetje dhe respektim te plote te dispozitave kushtetuese dhe ligjore (*ne vazhdimesi dhe perputhje me ndryshimet ligjore te K.Pr.Penal te ketij viti*), si dhe ato qe burojne nga marreveshjet nderkombetare te ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise, duke respektuar dhe urdherat dhe udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem te Republikes se Shqiperise.

Prokuoret dhe Of/Pol/Gjyquesore te Prokurorise, duke perfshire ketu dhe trupen e sherbimeve te Policise Gjyquesore prane Komisarjatit te Policise Kavaje, gjate kesaj periudhe qe analizojme rezulton se i jane perkushtuar punes, duke ju permabjatur respektimit te ligjit si detyrim paresor, krijuar kushtet ligjore te zbatimit te drejtave te njeriut, per arritjen dhe venien para pergjegjesise penale te autoreve te kryerjes se veprave penale, por gjithnje duke respektuar te drejtat procedurale ndaj tyre gjate procesit hetimor.

Nje vemendje e veçante ne pjesen e dyte te kesaj periudhe, pra pas hyrjes ne fuqi te ndryshimeve ligjore sipas ligjt nr. 35/2017, i eshte kushtuar respektimit te te drejtave te personave ne hetim e ne menyre te veçante atyre me masa sigurimi shtrenguese (*kartat e te drejtave sipas neneve 34/a, 34/b, 35 te K.Pr.Penale*)

Gjate vitin 2017, per perballimin e punes dhe ushtrimin e veprimtarise Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje ka patur ne perberje te organikes se saj 6-Prokurore dhe Drejtuesin e Prokurorise, 3-oficere te policise gjyqesore, si dhe 6-punonjes te administrates. (organika)

Por duhet evidentuar qe ne fillim te analizes e punes, qe gjate keij viti ka patur shume ndryshime sa i perket levizjes se Prokuroreve, ku nje Prokuror eshte larguar per shkak te mbushjes se moshes se pensionit (Y.Dhimitri), nje Prokurore ka qene me leje lindje (O.Rrumbullaku), me pas eshte komanduar nje Prokuror (K.Ajazi), dhe pas largimit te ketij te fundit jane komanduar dy Prokurore te tejre (D.Nushi dhe G.Habazaj) Tashme prokurori D.Nushi eshte larguar perseri per arsyte te mbarimit te komandimit. Kjo ka shkaktuar zevendesimet ne nje numer rreth 50% te çeshtjeve te Prokuroreve gjate vitit.

Megjithate mendoj se eshte punuar mire, rastet e referuara jane trajtuar me kujdes, jane bere perpjekje maksimale per te patur nje tregues te mire ne zgjidhjen e çeshtjeve si nga pikepamja profesionale, por dhe treguesve te tjere te shpejtesise ne hetim, gjetjes se nje raporti te drejte te vendosjes se masave te sigurimit ndaj autoreve, por dhe ne aspektin e perfaqesimit ne Gjykate te kerkesave dhe qendrimeve te mbajtura deri ne masat e denimit.

Treguesit e punes tone ne per gjithesi dhe asaj ne veçanti te çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqesore, do ta realizonim duke ju referuar te dhenave statistikore 1-vjeçare qe analizojme pra vitit 2017.

## **I. Volumi i kallzimeve penale - akteve te referuara, dhe çeshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2017.**

Jane regjistruar (*protokolluar*) ne sekretarine e Prokurorise Kavaje, referime per vepra penale per vitin 2017, **1084 -materiale** (6-me shume se 2016) nga keto 1003 - te referuara nga sektoret e sherbimeve te Pol.Gjyqesore prane Komisarjatit te Policise Kavaje, 45-materiale kallzuese nga Institucionet, 23-materiale kallzuese nga qytetaret, si dhe 13-çeshtje penale te ardhura me kalim aktesh per kompetence nga Prokurorite e tjera.

Ne krahasim me vitin e meparshem rezulton nje renie e kallzimeve nga Institucionet., nga 60/2016 ne 45/2017. Evidentojme se nga K.L.Sh ka vetem 1-kallzim penal (gusht 2017), ne lidhje me auditin ne Bashkine Kavaje, çeshtje e cila eshte ne hetim.

Pra evidentohet nje tendenze rritje e lehte te numrit te pergjithshem nga viti i 2016, te referimeve per fakte dhe ngjarje kriminale ne teresi, gje qe do te analizohet nga treguesit konkrete dhe per grup veprash penale.

### **Evidence e Refererimeve dhe kallzimeve te regjistruara ne Prokurori**

Viti	Referime nga sherbimet e policise	Kallzime nga Institucionet	Kallzime nga shtetasit	Gjithsej
2015	937	18	10	965
2016	986	60	32	1078
<b>2017</b>	<b>1003</b>	<b>44</b>	<b>23</b>	<b>1084</b>

Te gjitha rastet e akteve te referuara apo kallzimeve te paraqitura jane trajtuar me perjegjesi, duke i evidentuar ne regjistrat perkates, duke marre vendime perkates ligjore, regjistrimi apo mosfillimi te çeshtjes penale sipas rastit.

Nga kallezimet penale dhe referimet e protokolluara ne sekretari dhe regjistrin perkates ne **437-raste eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal** ne baze te nenit 290/-291/ te K.Pr.Penale ( nje rritje perseri e lehte nga viti i kaluar prej 14-raste, ku ne 2014 ka patur 392-mosfillime, ne 2015 ka patur 413- mosfillime, dhe ne 2016 ka patur 423-mosfillime.

Ndersa **eshte vendosur regjistrimi per 628- çeshtje penale** (nga 620 per vitin 2016 ,pra 8 - çeshtje te rregjistruara me shume se nje vit me pare).

Viti	Referime kallzime	Mosfilluar	Regjistruar
2015	965	413	496
2016	1078	423	620
<b>2017</b>	<b>1084</b>	<b>437</b>	<b>628</b>

Me qarte veprimtaria e Prokurorise do te rezultoj duke analizuar treguesit sipas dinamikes se trajtimit gjate hetimeve dhe vendimarries referuar dhe praktikes procedurale qe ndiqet, nga momenti i konstatimit te veprave penale nepermjet vend-ngaçjeve, kallzimeve penale etj, trajtimit ne aspektin ligjor, shpejtësise ne hetim etj, qe te krijonim nje tablo sa me te qarte te pasqyrimi te rezultateve apo mangesive dhe problematikave te evidentuara.

## **II. MOSFILLIMET (sipas neneve 290/-291/ te K.Pr.Penale)**

Eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal ne baze te neneve 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale, per **437-referime aktesh**.

Sa i perket tendences te natyres se veprave penale te referuara, ne numrin 437-te vendimeve te vendimeve te mosfillimit rezultojne ne numer te konsiderueshem si me poshte :

- per nenin 89 te K.Penal jane 23-vendime mosfillimi,
- per nenin 90 te K.Penal jane 72-vendime mosfillimi,
- per nenin 84 te K.Penal jane 36 vendime mosfillimi,
- per nenin 99 te K.Penal jane 36-vendime mosfillimi,
- per nenin 130/a/ te K.Penal jane 10-vendime mosfillimi, (renie e ndjeshme nga viti 2016 qe kishte 32-mosfillimi )
- per nenin 277 te K.Penal jane 14-vendime mosfillimi, dhe
- per nenin 199/a/1 te K.Penal jane 47-vendime mosfillimi.
- per nenin 290/1 te K.Penal jane 25-vendime mosfillimi.
- per fakte, te konsideruara ngjarje aksidentale, qe nuk perbejne fakt penal, jane 33-vendime mosfillimi.

Ne te gjitha rastet, ne arsyetimin e vendimeve eshte bere dhe orientimi per t'ju drejtuar Gjykates per raste konkrete me padi civile, apo ankim direkt ne Gjykate sipas nenit 59 te K.Pr.Penale.

Evidentojme se ne lidhje me vepren penale te parashikuar :

- per nenin 290/1 te K.Penal (Shkelja rregullave te qarkullimit rrugor) eshte vodosur mosfillimi per 25-raste.

Ky numer duhet konsideruar i ndjeshem per kete vepre penale ne ngarkesen e punes se Prokuroreve, duke patur parasysh se jane raste te veprimeve hetimore me vend-ngaçje, qe permbajne ne teresine e tyre te gjithe dinamiken e veprimeve per nje çeshtje konkrete, pra nje volum, por qe per shkak te elementit te pasojeve ne keto raste eshte vodosur sipas nenit 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale.

Duhet evidentuar fakti qe ne te gjitha rastet e siperpermendura per nenin 290/1 te K.Penal nuk ka patur ankim ne Gjykate, ç'ka konfirmon zgjidhjen e drejtë te ketyre rasteve.

Gjithashtu per te gjitha rastet duhet evidentuar njoftimi dhe Sektorit te Policise Rugore per marrjen e masave administrative (vodosjen e gjobave) ndaj drejtuesve te automjeteve.

- Per nenin 99 te K.Penal (*tentatives per vetevrasje neni 99 K.P*), eshte vodosur mosfillimi per 36-raste.

Jane marre deklarime te sakta personave qe kane dijeni per faktin, dhe pas evidentimit te mungesese se elementeve te ndonje vepre penale (kryesisht per nenin 99 te K.P) eshte vodosur mosfillimi.

Ne te gjitha rastet e mosfillimit te çeshtjeve jane bere njoftimet e vendimeve te mosfillimit paleve te interesuara gje qe evidentohet si nga korespondanca e shkreses ashtu dhe kopjet e vendimeve te konfirmuara dhe te administruara ne fashikujt perkates.

Nga 437 - vendime mosfillimi, *jane ankimuar 21-vendime* prane Gjykates se rrerhit Gjyqesor Kavaje, per te cilat per 7 - raste eshte vodosur prishja e vendimit te mosfillimit, per 13 - raste ankim, eshte lene ne fuqi vendimi mosfillimit te Prokuroreve.

Ndersa per 1-rast eshte ne gjykim.

Duhet evidentuar fakti se nje pjese e madhe e kallzimeve per te cilat eshte vodosur mosfillimi, jane kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke argumentuar plotesisht shkaqet e mosfillimit.

### **Evidence e trajtimit te rasteve ne faze verifikimi (Mosfillimet)**

Regjistruar ne faze verifikimi	Mosfilluar	Mbartur ne 2018	Ankuar	Dinamika e zgjidhjes
456	437	19 (tashme te perfunduara)	21	➤ 7-prishur (rifilluar) ➤ 13-lene ne fuqi

- Pra referuar evidences se mesiperme rezulton se eshte bere nje pune e mire ne lidhje me trajtimin e materieleve fillestare, ku ankimimet vetem per 21-vendime mosfillimi eshte nje tregues domethenes per cilesine e vendimarrjes se mosfillimeve.
- Duhet evidentuar fakti se per gjithesisht eshte respektuar afati 30-ditor (*sipas urdherit te Prok/Pergjithshem*) ne nje pjese te konsiderueshme te rasteve te mosfilluara, e pas ndryshimeve ligjore afati tashme proçedural 15-ditor. (*ligji nr.35/2017*)
- Por ka patur raste se ndonese data ne vendim mund te jete vendlor brenda afatit qe parashikon Urdheri i Prokurorit te Prgjithshem, ne zyren e Drejtuesit, fashikulli per kontroll eshte paraqitur me kohe vonese, kjo e pasqyruar ne shkresat perkatese.
- Duhet evidentuar se, si shkak ne kalimin e ketij afati (30-ditor), rezultojne referimet e akteve me mangesi (te dukshme), apo raste te konflikteve te pronesise qe kane te bejne me administrim te praktikave administrative apo gjyquesore per te bere nje konkludim te sakte ne vendim, si dhe vonesat ne konfirmimet e akteve te ekspertimit mjeko-ligjor.

### **III. CESHTJE PENALE TE REGJISTRUARA DHE HETUARA.**

Ne vitin 2017 jane regjistruar gjithsej 628-ceshtje penale.

Te mbartura nga viti 2016 140-ceshtje penale, dhe 12-ceshtje te ri-flluara hetimet.

Pra per vitin 2017 rezultojne **780-ceshtje penale te hetuara**.

- ✓ Kane perfunduar hetimet gjithsej per **609-ceshtje penale**.

Pra nga numri i per gjithshem i kallzimeve penale dhe i çeshtjeve te regjistruara rezulton se gjate kesaj periudhe ka patur nje rritje te kallzimeve dhe çeshtjeve penale te regjistruara dhe hetuara, dhe konkretisht ne vitin 2012 jane regjistruar 294-proçedime penale, ne vitin 2013 jane regjistruar 600, ne vitin 2014 jane regjistruar 684-ceshtje penale, ne vitin 2015 jane regjistruar 497-ceshtje penale, ne vitin 2016 jane regjistruar 620-ceshtje.

### **Evidence e çeshtjeve te regjistruara dhe hetuara**

Viti	Mbartur nga viti para -ardhes	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Perfunduar
2015	199	496	695	523
2016	172	620	792	647
<b>2017</b>	<b>140</b>	<b>628</b>	<b>780</b>	<b>609</b>

Pra ti referohesh tabellese se mesiperme rezulton se 3-vitet e fundit ka nje renie te mbartjes se çeshtjeve, pra çeshtjet jane evaduar, per shkak te vleresimit dhe respektimit te afateve.

### **DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PERHAPJES SE VEPRAVE PENALE NE PERGJITHESI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NE VECANTI.**

Sa i perket tendencies se natyres kriminalitetit, te perhapjes se veprave penale ne pergjithesi apo me grup veprash penale te vecanta rezulton se veprat penale me nje shtrirje dhe perhapje me te madhe jane ato te :

- **kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike me 357-procedime penale.** (bashke me te mbartura)

Evidentojme se

- ✓ per nenin 134/ te K.Penal 223-procedime penale,
- ✓ per nenin 199/a/- te K.Penal 31-procedime penale,
- ✓ per nenin 137/ te K.Penal 10-procedime penale,
- ✓ per nenin 143/ te K.Penal 16-procedime penale,
- ✓ per nenin 150 te K.Penal 19-procedime penale.

- **kunder autoritetit te shtetit, respektivisht 260-procedime penale (rritje me rreth 60-ceshtje nga viti kaluar)**

Nga keto

- ✓ per neni 248 K.Penal 16-procedime penale,
- ✓ per neni 283/1,2 K.Penal 27-procedime penale,
- ✓ per neni 290/ K.Penal 36-procedime penale,
- ✓ per neni 291 K.Penal 95-procedime penale

Duhet evidentuar çeshtja penale nr. 92/2017 qe ka te beje me trajtimin e tokave ne zonen e plazhit Spile Kavaje, per veprat penal te parashikuara nga nenet 186/3 – 248 te K.Penal, me 12-persona te pandehur, nga te cilet 9-te me mase sigurimi ërrest ne burg”.

- Veprat penale te drejtuara **kunder jetes se personit rezultojne se jane regjistruar 107-procedime penale.**

Nga keto

- ✓ 1-procedim penale per nenin 76 K.Penal (me nje viktime)
- ✓ 1-procedim per nenin 78 te K.P (nje viktime),
- ✓ per nenin 79/e 1-procedim (nje viktime) (*te mbartura ne hetim nga viti 2016 dhe perfunduar ne vitin 2017*),
- ✓ per nenin 88 te K.Penal 4-çeshtje penale,
- ✓ per nenin 89 te K.Penal 23-çeshtje penale,
- ✓ per nenin 130/a/.. te K.Penal 45-çeshtje penale.
- ✓ per nenin 291 te K.Penal 95-çeshtje penale
- ✓ per nenin 199/a/1,2 te K.Penal 31 çeshtje penale
- ✓ per nenin 137/1,2 te K.penal 10 çeshtje penale

- Veprat penale te drejtuara **kunder veprimtarise shteterore, rezultojne se jane regjistruar 7-procedime penale.** (vepra penale te natyres korruptive)

Nenet 244 – 259 te K.Penal (korruption aktiv e pasiv) rezultojne 7-çeshtje te regjistruara, nga te cilat kane perfunduar hetimet e derguar per gjykim per 4-çeshtje, pushuar 2-çeshtje dhe 1-ne hetim.

- Veprat penale **qe prekin zgjedhjet ...., rezultojne se jane regjistruar -procedime penale.**

Per nenet 326/2 te K.Penal 1-çeshtje e cila eshte ne hetim, kallzim nga komisioni qendor i Zgjedhjeve.

Per nenin 329/1 te K.Penal 1-çeshtje e cila eshte pushuar.

#### **IV. MENYRA E PERFUNDIMIT TE CESHTJEVE.**

( Personat ne hetim, masa sigurimit, pushimet, pezullimet dhe te derguara per gjykim)

Kane perfunduar hetimet dhe eshte konkluduar ne vendim perfundimtar per 609 çeshtje penale per vitin 2017, duke mbartur ne hetim 171-çeshtje penale per vitin 2017.

Rezulton se nga **609 - çeshtje te perfunduara:**

- **244 - çeshtje jane derguar per gjykim, ( 40 % ).**
- **144 -çeshtje jane pushuar, ( 125-vendime pushimi me proceduren e kohes, dhe 19-kerkesa per pushim ne Gjykate sipas ligjit 35/2017 date 01.08.2017 ) (24 %)**
- **200- çeshtje jane pezulluar (33 %),**
- **18 -çeshtje jane transferuar per kompetence**
- **171- çeshtje jane mbartur per vitin 2018.**

Tabele permblehdhese

Mbartur	Regjistruar	Hetuar	Gjygjit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim 2017
140	628	780	244	144	200	18	171

#### **• PERSONA NEN HETIM, DHE MASAT E SIGURIMIT**

Regjistruar emri si person nen hetim.

Ne keto procedime penale rezulton se eshte regjistruar emri per 377-persona me cilesine e te dyshuarit per nje veper penale ne urdherin e regjistrimit, pra me cilesine ndaj te cileve zhvillohen hetime.

Nga keta kane perfunduar hetimet per 329-persona,

- ku 279-personave u jane njoftuar akuzat perkatese „njoftimit te akuzes neni 34 K.Pr.P“ dhe jane derguar per gjykim,
- per 12-persona nen hetim eshte vendosur transferimi i procedimeve penale, ndersa

- per 38-persona eshte vendosur pushimi i çeshtjes penale ne ngarkim te tyre,
- per 48- persona nen hetim jane mbartur per vitin 2018.

### Masat e sigurimit .

Nga personat nen hetim mbi bazen e referimit te akteve paraprake kane ardhur me mase shtrenguese te vendosur nga sherbimet dhe seksioni i Pol/Gjyqesore, “arrest ne flagrance“ 173-persona te dyshuar, dhe “ndalim“ 9-persona te dyshuar, pra gjithsej :

**182-persona te dyshuar me mase shtrenguese per vitin 2017. (pra 3-masa shtrenguese me shume se viti 2016)**

Ne asnje rast arrestimi dhe ndalimi nuk eshte urdheruar lirim i menjehershëm.

Eshte kerkuar vleftesimi i arrestit ne flagrance dhe ndalimit per 182 - persona te dyshuar.

Gjykata per 181 - raste ka vleftesuar te ligjeshem masat shtrenguese, per 1- urdher ndali eshte vendosur nga Gjykata si i paligjeshem.

Nga Prokuroria eshte kerkuar caktim mase sigurimi 182-persona te dyshuar, ku eshte kerkuar masa e sigurise si me poshte :

- **70-te dyshuar „arrest ne burg“** sipas nenit 238 te K.Pr.Penale,
- **3-te dyshuar “arrest ne shtepi”** sipas nenit 237 te K.Pr.Penale,
- **2-te dyshuar “arrest ne burg” me afat,**
- **2-te dyshuar “garanci pasurore“** sipas nenit 236 te K.Pr.Penale,
- **105-te dyshuar “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore“** sipas nenit 234 te K.Pr.Penale.

Nga **Gjykata eshte vendosur** per :

- 67-persona “arrest ne burg”,
- 4-persona “arrest ne shtepi”,
- 2-persona “arrest ne burg me afat”,
- 2-persona “garanci pasurore”
- 107-persona masa e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore”.
- Per **12 - persona te dyshuar** gjate hetimeve paraprake eshte kerkuar **masa e sigurimit kryesisht nga Prokuroria “arrest ne burg” ne mungese dhe miratuar nga Gjykata.** (ekzekutuar me pas teresisht per te gjithe personat)

## **Te dhenat permbledhese per autoret dhe masat e sigurimit**

Regjistruar emri nen hetim	Te pandehur (njotuar akuza)	Masa sigurimit				Gjykim	Pushuar	Transferuar	Ne hetim
		Neni 234	Neni 236	Neni 237	Neni 238				
377	279	107	2	4	67	279	38	12	48

*Me poshte po analizojme menyren e perfundimit te çeshtjeve te regjistruesa dhe hetuara, dhe konkretisht.*

### a) **CESHTJE TE DERGUAR NE GJYKATE**

Pas perfundimit te hetimeve jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje **266-procedime penale me 279 - te pandehur.**

Pra 34-çeshtje dhe 11-te pandehur me shume se viti 2016.

Nga te cilet me mase sigurimi “Arrest ne Burg” jane derguar per gjykim 84-te pandehur.

Duke ju referuar veprave penale per te cilin Jane akuzuar e derguar per gjykim te pandehurit, rezulton si me poshte :

- Per vepren penale **kunder autoritetit te shtetit** (kunder veprimtarise shteterore-kunder rendit dhe sigurisnenet 235-299 te K.P) jane derguar per gjykim **136 - procedime penale me 142 - te pandehur ku nga keto 23 te arrestuar.** (Pra 40-çeshtje me shume se viti 2016)
  - ✓ *Duhet evidentuar se rezultojne per nenin 236 te K.Penal 6-procedime penale me 9-te pandehur.*
  - ✓ *Per vepren penale te “Mosbindja ndaj punonjesit te policise se rendit” neni 242 i K.Penal 1-procedime penale me 1-te pandehur.*
  - ✓ *Per vepren penale te “Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike” neni 244 i K.Penal 4-procedime penale me 4-te pandehur.*
  - ✓ *Per vepren penale te “Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor” neni 290/ i K.Penal 14-procedime penale me 14-te pandehur.*
  - ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 291 te K.Penal jane derguar per gjykim 85-procedime penale me 85-te pandehur. Rritje e ndjeshme nga 18-çeshtje ne 2016.*
  - ✓ *Per vepren penale te parashikuar nga neni 248 te K.Penal jane derguar per gjykim 2-procedime penale me 2-te pandehur.*

- Per veprat penale **kunder pasurise** 134/- 200 te K.Penal jane derguar per gjykim 66-procedime penale, me 71-te pandehur ku nga keto 27-te pandehur te arrestuar. (renie nga një vit me pare 82 çeshtje te 2016)

*Evidentojme se per:*

- ✓ *nenet 134/1,2 te K.Penal 22-procedime me 26-te pandehur ku nga keto 23-te arrestuar,*
- ✓ *neni 137/1,2 i K.Penal 5-procedime me 5-te pandehur,*
- ✓ *neni 199/1,2 te K.Penal 18-çeshtje me 18-te pandehur.*

- Per veprat penale te seksionit te fallsifikimit te dokumentave nenet 190/ te K.Penal (ne lidhje me kallzimet ne kuader **te ligjit per dekriminalizimin**) rezulojne 3-çeshtje penale.
- Per veprat penale **kunder jetes se personit** nenet 76-133 te K.Penal Jane deguar per gjykim 39-procedime penale, me 40-te pandehur ku nga keto 20-te arrestuar.

*Evidentojme se per*

- ✓ *nenit 88 te K.Penal jane derguar per gjykim 1-procedime penale me 1-te pandehur ku 1- me mase sigurime “arrest ne burg ne mungese”,*
- ✓ *per nenin 89 jane derguar per gjykim 4-çeshtje me 5-te pandehur,*
- ✓ *per nenin 130/a/1,4 jane derguar per gjykim 23-çeshtje me 34-te pandehur me 6- me mase sigurimi arrest ne burg.*

- Per veprat penale **kunder drejtisise** nenet 300-324/a te K.Penal Jane deguar per gjykim 24-procedime penale, me 26-te pandehur ku nga keto 14-te arrestuar.

*Evidentojme se:*

- ✓ *per nenin 324/a/1 te K.Penal jane derguar per gjykim 21-procedime penale me 23-te pandehur ku 21- Jane me mase sigurime “arrest ne burg,*
- ✓ *per nenin 320 te K.Penal eshte derguar per gjykim 1 - çeshtje penale me 1 - te pandehur,*
- ✓ *per nenin 305 te K.Penal 1-çeshtje me 1-pandehur.*

**b) CESHTJE PENALE TE PERFUNDUARA GJYKIMI PER VITIN 2017**

Gjate vittit 2017 pas dergimit te çeshtjeve penale per gjykim, ka perfunduar gjykimi per 258-procedime penale me 287-te pandehur nga te cilet 88-te pandehur me mase sigurie “arrest ne burg”. (*perfshire dhe dosjet ne gjykim te mbartura nga 2016*)

**Nga Prokuroria**

- Per 107 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim.

Nga te cilet vetem per 2 - te pandehur ne kufijte prane minimumt te denimit, 103-te pandehur ne kufijte mesatar te denimit, 1-pandehur me denim maksimal, dhe 1-pandehur me denim burgim te perjetshem.

- Per 154-te pandehur eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te denimim me burgim ( neni 59 K.Penal) duke perfshire ketu dhe nenin 63 te K.Penal.
- Eshte kerkuar denimi me gjobe per 13-te pandehur.
- Per 13-çeshtje (me 13-te pandehur) eshte kerkuar pushimi i gjykimit te çeshtjes, per efekt te heqjes dore nga ankimi ne Gjykate (çeshtje me ankim neni 89 K.P, dhe Amnistia e vitit 2016)
- Nga **Gjykata** ne lidhje me kerkesat e bera nga Prokuroria qe parashtruan me siper eshte vendosur deklarimi fajtor per 272 te pandehur (nga 287 te kerkuar nga Prokuroria pasi per 2-te pandehur eshte vendosur pafajesi dhe per 13-te pandehur eshte pushuar gjykimi).
- Eshte vendosur denimi me burgim per 105 - te pandehur (nga 107-te kerkuar nga Prokuroria)
- Eshte vendosur denimi sipas nenit 59 dhe 63 te K.Penal per 154-te pandehur.

Evidentojme faktin qe nje pjese e madhe e denimeve me kusht (pezulluara ekzekutimin e denimit me burg neni 59 K.P) dhe detyrimit per te bere nje pune me interes publik kane te bejne me vepra penale te parashikuara nga nenet 291 dhe 199/a/1 te K.penali.

- Eshte vendosur denimi me gjobe per 13 te pandehur (nga 13-te kerkuar nga Prokuroria)

Siq shikohet nga statistika e mesiperme rapporti i kerkesave per mase denimi te Prokurorise me vendimet e dhena nga Gjykata rezulton nje raport pa ndryshime thelbesore si ne llojin ashtu dhe ne masen e denimit.

Ne kete veshtrim jane analizuar dhe qendrimet per apelim me kete report ndryshimesh te kerkesave dhe dhenies se vendimeve.

## Ankimet ne Gjykaten e Apelit

Nga çeshtjet e gjykuara dhe te perfunduara ne Gjykaten e Rrethit e Gjyqesor Kavaje ne 9 - raste eshte ushruar ankim ne Gjykaten e Apelit Durres.

Eshte ushruar ankim per 3-vendime per masa sigurimi ku ne perfundim te gjykimeve ne Apel eshte pranuar kerkesa e Prokurorise per 1-rast, qe ka te beje me masen e sigurimit “arrest ne burg”.

Gjithashtu eshte ushruar ankim per 9-çeshtje, vendimi themeli te cilat ne 3 - raste eshte prishur vendimi i Gjykates Kavaje (1-per pafajesi), per 1-rast pushuar, dhe ne 4-rastet e tjera nuk ka perfunduar gjykimi ne Apel, dhe 1-rast eshte ne gjykim.

Ceshtje te Gjykuara	Te pandehur	Fajesi	Pafajesi	Ankim	Gjykata Apelit
Kerkesa Prokurorise	287	274		9	
Vendimi Gjykates	287	272	2		3-pranuar 4-mos pranuar 1-pushuar 1- ne gjykim

Por duhet evidentuar dhe nje numer i konsiderueshem gjykimesh, mbi bazen e kerkesave te denuarve me objekt “lirim me kusht” nen 64 K.Penal, qendrim ne shtepi” nen 59/a K.Penal, si dhe kerkesat per njohje Amnistie.

Kemi parasysh se Gjykata Kavaje mbulon ne juridikcionin e saj I.E.V.P Rrogozhine.

Rezulton se jane trajtuar ne gjykim 204 – kerkesa me objektet kerkese sipas neneve 64 – 59/a/ te K.Penal.

Duhet sqaruar dhe evidentuar se 204-kerkesa, te kaluara per gjykim, me nje llogaritje te thjeshte me minimum seancash, rezulton ne rrerh 800-seanca gjyqesore.

Pra eshte nje mbingarkese e perballuar nga Prokuroret, perveç çeshtjeve te dinamikes te derguara ne gjykim.

Shtojm ketu dhe specifiken e largesise Gjykates me Prokurorine, dhe numrin e vogel te gjyqtareve, te cilet dhe objektivisht detyrohen te shtyjne seancat.

Evidentojme dhe 38-kerkesa per pushimin e çeshtjeve me parashkrim sipas nenit 66/ te K.Pr.Penale, pas ndryshimeve ligjore te dates 01.08.2017.

Duhet evidentuar fakti, qe ka nje mbingarkese te perfaqesimit ne seancat gjyquesore.

Se pari ka nje numer te konsiderueshem te çeshtjeve per gjykim themeli, duke shtuar ketu dhe masat e sigurimit. (mbi 600-seanca gjyquesore)

Se dyti numri i konsiderueshem i kerkesave per L.P.K dhe qendrim ne shtepi, etj (rreth 800 seanca)

Pra rezulton se prokuroret kane marre pjesë ne mbi 1.400 seanca gjyquesore.

#### **c) PROCEDIMET PENALE TE PUSHUARA**

Gjate ketij viti nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje eshte vendosur pushimi per 125-procedime penale me 38-autore te regjistruar emri. Ne kete numer duhet shtuar dhe per 19-çeshtje qe eshte proceduar me kerkese per pushim ne Gjykate (*ndryshimet sipas ligjit nr.35/2017*)

Duke ju referuar statistikes rezulton se :

Per 3-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/a (fakti nuk ekziston) te K.Pr.Penale.

Per 5-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/dh te K.Pr.Penale (per mungese provash).

Per 21-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te ligjit “Per Amnistine.

Per 15-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/c – 286 K.Pr.Penale (heqja dore nga ankimi) kryesisht per nenet 275, 89 K.P.

Per rastet e tjera procedime penale jane pushuar per shkaqe te tjera, kryesisht qe u perkasin neneve 150, 199/a, 130/a/ te K.penal.

Duke ju referuar grup veprave penale per te cilat eshte rregjistruar procedimi rezulton se eshte vendosur pushimi si me poshte :

## Konkretnisht

- ✓ per nenin 248 te K.Penal 3-procedime penale.
- ✓ per nenin 290/1,4 te K.Penal 9-procedime penale.
- ✓ per nenin 287/ te K.Penal 3-procedime penale.
- ✓ per nenin 199/a/1 te K.Penal 8- procedime penale.
- ✓ per nenin 130/a/1 te K.Penal 8 - procedime penale.
- ✓ per nenin 89 te K.Penal 15 - procedime penale.
- ✓ per nenin 283/1 te K.Penal 4- procedime penale,
- ✓ per nenin 84 te K.Penal 4- procedime penale.
- ✓ per nenin 275 te K.Penal 16-procedime penale.

Pra rezulton se nje numer i konsiderueshem çeshtjesh jane pushuar per shkak Amnistie te vitit 2016, si dhe ne rastet e heqjes dore nga ankimi.

Duhet evidentuar se jane pushuar dhe çeshtje per vepren penale te “Ndertim i paligjeshem” parashikuar nga neni 199/a/1 te K.P, te cilat realisht ne fazen e pare jane regjistruar per shkak te paqqrtesive ne referim, me mangesi te vprimeve te para hetimore nga sherbimet e Policise, per te cilat duheshin kryer ekspertime teknike, per konkludimin e sakte nese jemi para vepres penale apo kundravajtjes administrative.

Ne lidhje me pushimet per vepren penale te “Dhunes ne familje” parashikuar nga neni 130/a/..te K.P, rezulton se me teper jane rastet kur duhej treguar kujdes, per hetimin e plote te rrethanave te rastit, si çeshtje qe ne shume raste rezultojne problematike, te ndjeshme, por dhe te diskutueshme sa i perkthet kualifikimit.

Rastet per vepren penale te “pastrimi i produkteve te vepres penale” parashikuar nga neni 287/ te K.penali, duhet evidentuar fakti se keto çeshtje referohen nga Policia thjesht me indicie, ne te shumten e rasteve per vlera monetare transaksione bankare relativisht te vogla, dhe jo te konfirmuara qarte ne lidhje me statusin gjyqesor te te dyshuarit.

Keto çeshtje jane diskutuar disa here me sherbimet e policise, por verejme nje tendence me shume statistikore te referimit nga policia, se sa raste te qarta dhe per subjekte reale te dyshimte.

## Ankimet ndaj vendimeve te pushimit.

Ne 17 - raste eshte bere ankirim ne Gjykate ndaj vendimeve te pushimit nga palet.

Ne 10-raste eshte prishur vendimi duke i kaluar per ri-hetime. (3-raste per nenin 290/ K.P, 1-rast i mbartur qe nga viti 2009 per nenin 151 K.P, djegia e nje magazine ne vlera te konsiderueshme, 1-rast per nenin 150 K.P, shperthimet me eksplazi ne nje miniere, duke demtuar disa banesa perreth

Ne 4-raste eshte lene ne fuqi vendimi i Prokurorit.

Ndersa 3-raste jane ne gjykim.

Duhet evidentuar se shumica e rasteve te prishjes se vendimeve, rezultojne per nenin 290/ te K.Penal, ku nga studimi i tyre arsyetimi ka te beje me shume me pretendimet e paleve per ri-ekspertim. Kjo po kthehet ne nje fenomen, per shkak dhe te procedurave tashme civile per shperblim demi civil, nepermjet kompanive te sigurimeve.

Por duhet terhequr vemendja se duhet bere me shume kujdes ne fazen fillestare, ku Prokuroret duhet te jene te vemendshem ne vendimarrjen per ekspertimet, perzgjedhjen e eksperteve, dhe fiksimin e te gjitha rr Ethanave dhe provave fillestare.

Eshte nderhyre per kete qellim, dhe mendojme se keto raste tashme rezultojne te qarta drejtim disiplinimit te kryerjes se procedurave te para hetimore, ne bashkepunim me seksionin e qarkullimit rrugor, per te mos lene hapesira per interpretimet.

#### ***d ) PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA***

Eshte vodosur pezullimi i hetimeve ne baze te nenit 326/1,2 te K.Pr.Penale per 200 - procedime penale te cilat jane te ndara me grup veprash:

- Vepra penale kunder pasurise rezultojne 161-procedime penale.

Keto procedime penale kryesisht jane me vend-nga jarje te referuara nga seksionet e policise gjyqesore prane Komisarjatit te Policise Kavaje.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar kryerja e veprimeve hetimore si dhe deleguar veprime specifike, dhe ne perfundim bazuar dhe ne relacionin e officereve te policise gjyqesore eshte vodosur pezullimi i hetimeve.

Ne kuptimin e figurave te krimtit te ketyre grup veprave penale duhet nenvizuar se per nenin 134/ te K.Penal rezulton pjesa me e madhe e tyre.

